



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 27 datë 29.4.2024**

**PËR**

**“DHËNIEN NË PËRDORIM TË PASURISË prej 140.42 ha NDODHUR NË EKONOMINË PYJORE “DRIN GJADËR KIR” PARCELA 004, 010, ZK 1690 NR PASURIE 893, NR PASURIE 888, PËR NJË PERIUDHË 10 VJECARE PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTE PËR PANELE FOTOVOLTAIKE ME QËLLIM PRODHIM ENERGJIE”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja 'e/l' ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 115/2014 date 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; neni 25 i ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronesi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar; VKM nr. 559 dt 29.07.2022 “ Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe përdorimet drusore jodrusore pyjore , si edhe proceduën e mbledhjes së tyre”, Udhëzimi i Ministrit të Turizmit e Mjedisit nr 1 dt. 09.06.2016 për “Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për Dhënie në përdorim të pasurisë prej 140.42 ha ndodhur në ekonominë pyjore “ Drin Gjadër Kir” parcela 004, 010, zk 1690 nr pasurie 893,

nr pasurie 888, për një periudhë 10 vjecare për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie”.

2. Bashkia Shkodër në vazhdim të procedurave të mëtejshme të zbatojë dispozitat që rrjedhin nga Ligji nr 111/2012 “ Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

\_\_\_\_\_  
**Oltion LLLI**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

\_\_\_\_\_  
**Denis Lasha**

Miratuar me 27 vota  
Vota Pro 27  
Vota Kunder 10  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 2.5.2024